VENDIM
Nr. 2, datë 17.2.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Elsa Toska	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Bina	anëtar;
Përparim Kalo	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.2.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 6 (D) 2021 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Dashmira Zaro.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bashkia Gjirokastër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Drejtoria Vendore Gjirokastër e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Gjirokastër e Avokaturës së Shtetit.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 2/5/2, datë 17.6.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE**:** Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi parashtrimet e kërkueses Dashmira Zaro, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi se subjektet e tjera të interesuara nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 322, datë 15.4.2015, "*Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, Rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit nga ana e qytetit, Ndriçimi i trotuarit në Parkun e Viroit nga ana e qytetit*" (*VKM nr. 322/2015*), ka vendosur shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit.

2. Mbi bazën e këtij vendimi, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Gjirokastër ka kufizuar pronën e kërkueses, të ndodhur në zonën e emërtuar Viroi–Gjirokastër, të cilën ajo e kishte fituar me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si trashëgimtare ligjore e ish-pronarit. Me pretendimin se i janë cenuar interesat e ligjshme për pronën e mbetur pas shpronësimit, kërkuesja ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

duke kërkuar konstatimin e vendosjes së kufizimit mbi tagrat e pronësisë që barazohet me shpronësimin e pjesës së mbetur të pronës pas shpronësimit me VKM-në nr. 322/2015, detyrimin e së padituri, ZVRPP-së, Gjirokastër, të hedhë gjurmën e projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, detyrimin e së padituri, bashkisë Gjirokastër, të ndalojë cenimin e pronës dhe të heqë barrierën e palëvizshme metalike nga rruga, si dhe detyrimin e të padituri, bashkisë Gjirokastër dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban, për nxjerrjen e akteve administrative që zgjidhin pasojat e përdorimit të pronës në funksion të rikonstruksionit të Parkut të Viroit.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr. 443, datë 18.7.2017, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke urdhëruar të padituri ZVRPP-në Gjirokastër, të hedhë gjurmën e projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe të pajisë kërkuesen me certifikatë pronësie për pronën e mbetur nga shpronësimi nëpërmjet VKM-së nr. 322/2015. Në lidhje me kërkimet e tjera, për konstatimin e vendosjes së kufizimit mbi tagrat e pronësisë që barazohet me shpronësimin dhe për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe nxjerrjen e akteve administrative, gjykata ka vendosur rrëzimin e tyre, kurse në lidhje me kërkimin për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe heqjen e barrierës së palëvizshme nga e paditura, bashkia Gjirokastër, ajo ka shpallur moskompetencën lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër si gjykata kompetente.

4. Duke mos qenë dakord me vendimin për dy disponime të tij, konkretisht për shpalljen e moskompetencës lëndore, si dhe për pjesën që ka rrëzuar kërkimin e padisë për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe nxjerrjen e akteve administrative, kërkuesja ka paraqitur ankim. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr. 392, datë 24.7.2017, ka vendosur mospranimin e ankimit për pjesën që ka shpallur moskompetencën lëndore. Pas zhvillimit të procedurave të ankimit në shkallën e dytë dhe në Gjykatën e Lartë për mospranimin e këtij ankimi, në përfundim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 29, datë 4.3.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mospranimit të ankimit për disponimin e shpalljes së moskompetencës lëndore, kurse Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 688, datë 27.4.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses.

5. Ndërkohë, për sa i takon ankimit të kërkueses për pjesën që ka rrëzuar kërkimin e padisë për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe nxjerrjen e akteve administrative, ai është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 19.9.2017.

6. Në datën 20.7.2018, kërkuesja ka paraqitur kërkesë me shkrim drejtuar relatores së çështjes dhe kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar përshpejtimin e gjykimit të çështjes.

7. Duke mos marrë përgjigje për këtë kërkesë, në datën 20.8.2018 kërkuesja, bazuar në nenet 399/1, 399/2, pikat 1, shkronja "a", dhe 2, si dhe 399/6, pika 1, shkronja "b", të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, duke kërkuar edhe urdhërimin e marrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes (*kërkesa për përshpejtimin e procedurave*).

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës i Lartë, me vendimin nr. 2/5/2, datë 17.6.2021, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkese, pasi nuk ka konstatuar zvarritje të qëllimshme të çështjes nga gjyqtari relator. Ndër të tjera, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes ishte rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret, se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh, duke krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore, por që këto vështirësi janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme të krijuar nga procesi i reformës. Sipas asaj gjykate parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Në asnjë rast cilësia e procesit të rregullt ligjor dhe e vendimmarrjes së gjykatës nuk duhet të sakrifikohet për "*sasinë e afatit të arsyeshëm*" ose edhe ekonominë gjyqësore në tërësi (*shih paragrafët 16 dhe 21, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

9. Në datën 30.8.2021, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm, si dhe shfuqizimin e

vendimit nr. 2/5/2, datë 17.6.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

10. Me vendimin e datës 2.11.2021, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 1.12.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

11. Gjykata Administrative e Apelit, në përgjigje të kërkesës së Gjykatës, me shkresën e datës 20.12.2021, ka informuar se: i. pranë saj ushtrojnë detyrën pesë gjyqtarë, ndërkohë që deri në muajin korrik të vitit 2021 kanë ushtruar detyrën nëntë gjyqtarë; ii. deri në datën 15.12.2021 ngarkesa varion nga 2049 çështje në 3707 çështje për çdo gjyqtar, ndërsa 3160 çështje janë ende të parishortuara; iii. janë duke u shqyrtuar çështjet e regjistruara në periudhën shtator 2016–shkurt 2017; iv. deri në datën 15.12.2021, janë dhënë 623 vendime themeli; v. për çështjen e kërkueses është caktuar gjyqtarja relatore, së cilës deri në datën 19.9.2017, i ishin caktuar 1443 çështje, ndërsa deri në datën 15.12.2021 i janë caktuar 3707 çështje; vi. numri i çështjeve të themelit të regjistruara deri në datën 19.9.2017, për të cilat ende nuk është dhënë vendim, ka qenë 10776, duke theksuar se në atë datë gjykata funksionon me 13 gjyqtarë; vii. në emër të kërkueses rezulton e regjistruar edhe një çështje tjetër me nr. 31140-03231-86-2019, datë 13.9.2019, për të cilën është caktuar gjyqtarja relatore dhe seanca gjyqësore është planifikuar në datën 21.12.2021.

12. Në datën 7.2.2019, është miratuar ligji nr. 111/2018, "Për kadastrën", me të cilin kompetencat e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe ZVRPP-së, Gjirokastër i kanë kaluar respektivisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore Gjirokastër. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprime prej tyre.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. ***Kërkuesja*** Dashmira Zaro në kërkesën drejtuar Gjykatës ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

13.1 *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka shqyrtuar ende çështjen e saj të regjistruar në datën 19.9.2017, ndonëse është tejkaluar afati i përcaktuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së.

13.2 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për përshpejtimin e procedurave pa analizuar interesat kushtetuese pronësore dhe rrethanat e çështjes. Në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk është analizuar as rreziku që passjell tejzgjatja e afateve të gjykimit, pasi vonesa e shqyrtimit të ankimit të kërkueses ka pamundësuar edhe ekzekutimin e kërkimeve të pranuara të padisë, që nuk janë apeluar nga palët ndërgjyqëse. Gjykata e Lartë ka përligjur tejzgjatjen e afatit të gjykimit, duke mos respektuar qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që justifikon vonesën në gjykim.

14. ***Subjekti i interesuar****,* Avokatura e Shtetit, ka prapësuar me shkrim, duke kundërshtuar pretendimet e kërkueses si vijon:

14.1 Nuk ka shkelje të së drejtës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, pasi zgjatja e afatit është rrjedhojë e faktorëve objektivë të njohur dhe të pranuar tashmë nga jurisprudenca kushtetuese dhe ajo evropiane.

14.2 Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit është i pabazuar, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është logjik, koherent dhe i strukturuar, si dhe përmbush kërkesat për një arsyetim të plotë ligjor dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese dhe evropiane. Vendimi i Gjykatës së Lartë është shterues, në përputhje me nenet 399/5 dhe 399/6, të KPC-së dhe respekton kufijtë e objektit të kërkesës.

15. ***Subjektet e interesuara,*** bashkia Gjirokastër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Drejtoria Vendore Gjirokastër e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

16. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

17. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesja, në thelb, ankohet për gjykimin përtej afatit të arsyeshëm të çështjes së saj në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili ende nuk ka përfunduar, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka rrëzuar kërkesën e saj për përshpejtimin e procedurave.

18. Për rrjedhojë, kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor që ajo kundërshton dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

19. Një kriter tjetër paraprak që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri, kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Përpara analizës së kriterit të shterimit të mjeteve ligjore efektive në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson të vërë në dukje jurisprudencën e saj në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm.

21. Fillimisht, kërkesat për gjykimin ose ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm nuk janë pranuar për shqyrtim nga Gjykata, me arsyetimin se nuk hynin në juridiksionin kushtetues. Gjykata e ndryshoi jurisprudencën e saj në vitin 2006, pas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në çështjen Qufaj kundër Shqipërisë, datë 18.9.2004, duke e konsideruar ekzekutimin e vendimeve brenda afatit të arsyeshëm si pjesë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 6, datë 31.3.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Në vijim, Gjykata, në bazë të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ka vlerësuar, gjithashtu, se mund të merren në shqyrtim prej saj edhe kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Me ndryshimet që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" (*ligji*

nr. 38/2017), të cilat hynë në fuqi në datën 5.11.2017, u përcaktua se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), llojet e mjeteve për t'u mbrojtur nga cenimi, si kërkesa për përshpejtimin e procedurave (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe çfarë konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7) deri tek marrja e vendimit dhe zbatimi i tij (nenet 399/8–399/12). Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore nëpërmjet të cilave individit i garantohet mbrojtja në rastet e cenimit të së drejtës për gjykimin ose për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm.

23. Duke iu referuar këtyre ndryshimeve ligjore, Gjykata ka vlerësuar se nuk mund të investohej për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke arsyetuar se legjislacioni i brendshëm parashikon tashmë mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues.

24. Pavarësisht kësaj qasjeje, individët kanë paraqitur sërish, drejtpërdrejt në Gjykatë, kërkesa të kësaj natyre, me pretendimin se mjeti ligjor që duhet të shterojnë, sipas dispozitave të reja të KPC-së, nuk është efektiv, si dhe duke parashtruar se edhe pse kanë shteruar formalisht këtë mjet dhe kanë kërkuar konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave në gjykatat e zakonshme, nuk kanë marrë përgjigje prej tyre. Nga shqyrtimi i këtyre rasteve, Gjykata, në analizë të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, ka pranuar se, në parim, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Në veçanti, për kërkesën për përshpejtimin e procedurave, Gjykata është shprehur se ky lloj mjeti është "efektiv" nëse arrin të përshpejtojë vendimmarrjen e gjykatës në fjalë (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në vlerësimin e efektivitetit në praktikë të këtij mjeti juridik, Gjykata analizon nëse ai është real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë, pra që ai nuk është një mundësi e tërthortë për kërkuesin. Në këtë kuptim, kur kërkesa për përshpejtimin e procedurave nuk i ka shërbyer qëllimit të saj - përshpejtimit të procedurave ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të çështjes, atëherë ky mjet juridik nuk ka qenë *efektiv* në praktikë, për rrjedhojë në këto raste Gjykata ka vlerësuar se kriteri i shterimit të mjetit juridik është përmbushur (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në zhvillimin e kësaj jurisprudence Gjykata ka mbajtur në konsideratë dy faktorë të rëndësishëm. I pari lidhet me faktin se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë ende një qëndrim të konsoliduar për mjetet juridike të parashikuara nga KPC-ja, duke qenë se rregullat ligjore respektive janë relativisht të reja (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa faktori i dytë ka të bëjë me qëndrimin e GJEDNJ-së, e cila është shprehur se në vlerësimin e efektivitetit të mjetit juridik që lidhet me vonesat procedurale është vendimtare të përcaktohet nëse ka mundësi që kërkuesit t'i sigurohet dëmshpërblim i drejtpërdrejtë dhe i shpejtë, në vend të mbrojtjes së tërthortë të të drejtave të procesit të rregullt ligjor *(shih Scordino kundër Italisë, 29 mars 2006, § 195; Sürmeli kundër Gjermanisë, 8 qershor 2006, § 101).*

27. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se, në ndryshim nga gjykimet e sipërcituara, kërkuesja formalisht i ka shteruar mjetet e ankimit, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë vendim për kërkesën e saj për përshpejtimin e procedurave. Konkretisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, edhe pse ka konstatuar se ishte kaluar afati i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit (*shih paragrafin 13, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në thelb, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se mosveprimi i asaj gjykate nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive dhe se nuk ka zvarritje të qëllimshme nga gjyqtari relator, por, në kuptim të nenit 399/2, të KPC-së, gjykata e apelit ka qenë në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës, akumulimit të çështjeve dhe shkurtimit të numrit të gjyqtarëve në sistem, pasoja këto të reformës në drejtësi (*shih paragrafët 15–22, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

28. Lidhur me argumentin e përdorur nga Gjykata e Lartë si shkak objektiv që shkarkon gjykatat e zakonshme nga përgjegjësia për tejkalimin e afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve, Gjykata është shprehur se ndonëse interpretimi rast pas rasti i ligjit, konkretisht nenit 399/2 të KPC-së, i takon vetë Gjykatës së Lartë, qasja për të mos llogaritur efektet e reformës së drejtësisë në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave nuk përputhet me standardin e "afatit të arsyeshëm" të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkesa për përshpejtimin e procedurave në rastin e kërkueses e ka humbur qëllimin e saj - përshpejtimin e procedurave ose parandalimin e tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Pra, mjeti juridik "kërkesa për përshpejtimin e procedurave", që kërkuesja ka pasur në dispozicion sipas dispozitave të KPC-së, në rastin e saj nuk ka qenë *efektiv*, në kuptimin që nuk ka qenë real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë.

29. Për sa më lart, ndonëse formalisht kërkuesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon ligji, Gjykata vlerëson se nga mënyra se si është trajtuar ky mjet nga Gjykata e Lartë, ai mbetet sërish një mjet ankimi joefektiv. Në këtë kuptim, i vetmi mjet në dispozicion të kërkueses për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual, për rrjedhojë në çështjen konkrete përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike.

30. Gjykata evidenton, gjithashtu, se në rastin konkret është vënë në dyshim mundësia që kërkesa për përshpejtimin e procedurave ka për t'iu përgjigjur në shkallën e duhur nevojës për të garantuar të drejtën e individit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në raport me mundësitë reale të sistemit gjyqësor, për shkak të volumit të lartë të çështjeve, si dhe burimeve njerëzore dhe infrastrukturore të tij në tërësi. Për pasojë, është e rëndësishme të theksohet se çështja konkrete, për shkak të veçantisë së rrethanave të saj, bën pjesë në situatat përjashtimore, pasi, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

31. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 17.6.2021, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 30.8.2021, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

32. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata çmon të evidentojë fillimisht se kërkuesja në objektin e ankimit kushtetues, krahas pretendimit për shqyrtimin e vonuar të çështjes së saj nga Gjykata Administrative e Apelit, ka kundërshtuar edhe vendimin e Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për përshpejtim, me pretendimin se i ka cenuar të drejtën kushtetuese për proces të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata ka arsyetuar më lart se mënyra se si ka vepruar Gjykata e Lartë e ka bërë këtë lloj mjeti ankimi joefektiv në rastin e kërkueses (*shih paragrafët 28–29 të këtij vendimi*). Për rrjedhojë, ajo nuk do ta analizojë veçmas këtë kërkim, por do ta konsiderojë atë në funksion të pretendimit thelbësor të kërkueses për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda afatit të arsyeshëm. Në vijim, Gjykata çmon se është i pabazuar prapësimi i subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, se "kërkesa nuk përbën aktualisht materie kushtetuese në kushtet kur për çështjen e kërkueses janë shprehur Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë", pasi ky pretendim u referohet rrethanave të faktit që lidhen me ecurinë e ankimit të kërkueses për shpalljen e moskompetencës lëndore (*shih paragrafin 4, të këtij vendimi*), ndërkohë që objekt i ankimit kushtetues individual është ecuria e gjykimit që lidhet me kërkimin e padisë për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe nxjerrjen e akteve administrative, gjykim i cili është duke u zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit. Si përfundim, Gjykata vlerëson se, në vështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të themelit përfshihet në juridiksionin kushtetues, prandaj në vijim do të analizojë bazueshmërinë e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

33. Kërkuesja pretendon se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

34. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se kërkimi për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes duhet të rrëzohet, pasi vonesa ka ardhur si rezultat i faktorëve objektivë.

35. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

36. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi. Te kohëzgjatja e përgjithshme e gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, sepse barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se thelbi i mosmarrëveshjes që po gjykohet nga Gjykata Administrative e Apelit lidhet me mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, prandaj ai gjykim përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 42 të Kushtetutës. Ankimi i kërkueses, që ka vënë në lëvizje gjykimin në shkallë të dytë, është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 19.9.2017 dhe ndonëse kanë kaluar më shumë se 4 vjet, kërkuesja ende nuk ka një vendimmarrje për çështjen e saj.

38. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata sjell në vëmendje se neni 48, i ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012)* parashikon se gjykata e apelit e shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së tij nga gjykata ku është paraqitur. Ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja "a"), që zgjatet edhe me 6 muaj të tjerë në rastin kur çështjet gjyqësore janë ende në proces gjykimi në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve (neni 109, i ligjit nr. 38/2017).

39. Duke konsideruar afatet ligjore në raport me kohëzgjatjen e çështjes së kërkueses, çështje e cila ka qenë në proces në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të KPC-së, Gjykata vlerëson se *prima facie* gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën Administrative të Apelit është tejzgjatur, fakt që pranohet edhe nga palët në proces. Konkretisht, kërkuesja pretendon se në gjykimin e çështjes së saj nuk janë respektuar afatet ligjore, duke u zgjatur në mënyrë të paarsyeshme dhe se, referuar jurisprudencës kushtetuese, vonesa nuk mund të justifikohet nga numri i lartë i çështjeve që kanë në shqyrtim gjykatat administrative. Ndërsa subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, është shprehur se ndonëse ka tejzgjatje të gjykimit, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkueses, duke arsyetuar se vonesa është rrjedhojë e efekteve të reformës në drejtësi, që përbën një problematikë që tejkalon rastin konkret. Në këtë situatë, për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit është e paarsyeshme, pra nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i. sjelljen e kërkueses; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. si dhe sjelljen e autoriteteve *(shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

i. Sjellja e kërkueses

40. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, duke analizuar rrethanat nëse kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse ai është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në

këtë drejtim *(shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes. Në mënyrë të pandërprerë ajo është interesuar për çështjen, duke kërkuar edhe përshpejtimin e gjykimit. Kështu, në datën 20.7.2018 (rreth një vit pas paraqitjes së ankimit), kërkuesja i është drejtuar kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe relatores së çështjes me kërkesë administrative për përshpejtimin e shqyrtimit të ankimit. Pasi nuk ka marrë përgjigje prej tyre, në datën 20.8.2018, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për përshpejtimin e procedurave.

42. Në përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret sjellja e kërkueses nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes së saj.

ii. Kompleksiteti i çështjes

43. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, sepse balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore konstatohet se çështja ka natyrë administrative, me katër kërkime në objektin e padisë që përfshijnë zbatimin jo vetëm të rregullave gjyqësore procedurale të ligjit nr. 49/2012, por edhe zbatimin e ndërthurur të një numri të konsiderueshëm ligjesh që lidhen me të drejtat e pronësisë, mënyrat e fitimit të saj, shpronësimin dhe detyrat e disa organeve shtetërore. Gjithashtu, Gjykata vëren se gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, në bazë të provave shkresore dhe se, krahas kërkueses, në gjykim janë thirrur palë ndërgjyqëse të paditura: bashkia Gjirokastër, Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia e Planifikimit të Territorit dhe ZVRPP-ja Gjirokastër. Në gjykatën e shkallës së parë çështja e kërkueses është regjistruar në datën 10.5.2017 dhe pas dy muajve, në datën 18.7.2017 ajo ka vendosur, ndër të tjera, që kërkuesja të pajiset me certifikatën e pronësisë për pronën e mbetur nga shpronësimi nëpërmjet VKM-së nr. 322/2015. Palët ndërgjyqëse nuk janë ankuar për këtë disponim, i cili nuk mund të ekzekutohet për sa kohë që çështja e kërkueses vijon pa vendimmarrje në gjykatën e shkallës së dytë lidhur me kërkimin tjetër të saj për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe nxjerrjen e akteve administrative.

45. Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje mbi ankimin e kërkueses, në cilësinë e palës paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit gjyqësor të shkallës së parë, me qëllim detyrimin e institucioneve shtetërore që të ndalojnë cenimin e tagrave të pronësisë dhe të nxjerrin aktet administrative për zgjidhjen e pasojave. Pas regjistrimit të çështjes, Gjykata Administrative e Apelit ka caktuar gjyqtaren relatore me short dhe nuk ka kryer veprime të tjera procedurale, si njoftimi i palëve për paraqitjen e parashtrimeve shtesë, caktimi i seancës ose marrja e provave.

46. Duke iu referuar aspekteve të mësipërme, Gjykata çmon se çështja e kërkueses paraqitet komplekse, por jo në masën që të justifikojë vonesën e gjykimit në shkallë të dytë për më shumë se 4 vjet.

iii. Sjellja e autoriteteve

47. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Në përmbushje të detyrimeve të nenit 42 të Kushtetutës, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vëren se gjykimi administrativ i ankimit të kërkueses vazhdon prej më shumë se 4 vjetësh pa vendimmarrje në shkallë të dytë, ndonëse ligjvënësi i ka përcaktuar gjykimet administrative si të shpejta, duke parashikuar afate të shkurtra

procedurale në ligjin nr. 49/2012 (*shih paragrafin 38 të këtij vendimi*). Kohëzgjatja e gjykimit administrativ ka sjellë vonesa edhe në ekzekutimin e kërkimit të pranuar gjyqësisht, të paankimuar nga palët ndërgjyqëse, për pasojë kërkuesja është vënë në pamundësi për të ushtruar lirisht të drejtën e pronës, të fituar nga zbatimi i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave për pjesën e pasurisë së saj të mbetur pas shpronësimit prej vitit 2015.

49. Kërkuesja ka parashtruar se Gjykata e Lartë e ka mbështetur arsyetimin e vonesës së gjykimit të çështjes, ndër të tjera, me ngarkesën e gjykatave, por që sipas jurisprudencës së Gjykatës kjo nuk mund të justifikojë cenimin e së drejtës kushtetuese të saj. Ndërsa subjekti i interesuar ka prapësuar se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkueses lidhet me ngarkesën e gjykatave për shkak të reformimit të sistemit të drejtësisë, që është një faktor që duhet marrë në konsideratë nga Gjykata, ashtu siç është vlerësuar edhe nga Gjykata e Lartë.

50. Për sa i takon këtij argumenti, Gjykata e Lartë, në vendimin për rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave të kërkueses, ka vlerësuar se ndonëse ka "*vonesë të gjatë*", ajo nuk përbën "*zvarritje të qëllimshme të shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari relator në Gjykatën Administrative të Apelit*". Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Lartë ka interpretuar konceptin "*pamundësi objektive*" të nenit 399/2 të KPC-së, duke përfshirë në të gjendjen e sistemit të drejtësisë për shkak të reformimit të tij, që ka shkaktuar uljen e numrit të gjyqtarëve dhe rritjen e ngarkesës së punës në gjykata dhe ka konkluduar se vonesat për shkak të reformës nuk duhet të llogariten në kohëzgjatjen e gjykimit (*shih paragrafët 16, 20 dhe 22, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

51. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 5, datë 1.3.2018; nr. 23, datë 20.4.2016; nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ndërhyn në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015; nr. 16, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Për sa më lart, ndonëse sipas nenit 141 të Kushtetutës Gjykata e Lartë ka në kompetencën e saj interpretimin e ligjit, Gjykata çmon se duhet analizuar nëse në interpretimin që ajo i ka bërë nenit 399/2 të KPC-së dhe zbatimin e tij në çështjen konkrete ka mbajtur në konsideratë standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se ligjvënësi në miratimin e neneve 399/1 e vijues të KPC-së ka synuar krijimin e një mjeti juridik efektiv për t'i garantuar individit të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, duke i dhënë një rol specifik gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe në veçanti Gjykatës së Lartë, që përmes shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim të parandalojnë shkeljet kushtetuese në zbatim të parimit të subsidiaritetit, pasi, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, në radhë të parë, funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Në vijim, Gjykata evidenton se argumenti kryesor që qëndron në thelb të interpretimit ligjor të Gjykatës së Lartë për "*pamundësinë objektive*" lidhet me ngarkesën e gjykatave, i cili nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë kohëzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit. Pa mohuar nevojën, rëndësinë dhe përfitimet që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, Gjykata rithekson se ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës dhe zgjidhjen e saj. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga vetë gjykatat për të nxitur përkohësisht përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe masa të tilla nuk rezultojnë efektive dhe tejzgjatja e procedurave kthehet në problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të ndërhyjë me miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta

për të marrë një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm *(shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Duke analizuar gjendjen e Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata vëren se në datën 19.9.2017, kur çështja e kërkueses është regjistruar, reforma kishte filluar të zbatohej dhe pranë asaj gjykate ishin regjistruar 10776 çështje në pritje për t'u shqyrtuar nga trembëdhjetë gjyqtarë që ushtronin detyrën në të. Në datën 15.12.2021, teksa reforma është ende në proces zbatimi dhe çështja e kërkueses vijon pa vendimmarrje, numri i gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit është ulur në pesë dhe ngarkesa e çështjeve është nga 2049 çështje në 3707 çështje për çdo gjyqtar, duke shtuar edhe 3160 çështje të regjistruara në pritje të rishpërndarjes për këta pesë gjyqtarë me anë të shortit. Edhe volumi i punës së gjyqtares relatore, që i është caktuar për shqyrtim çështja e kërkueses, është rritur, pasi në datën 19.9.2017 asaj i ishin caktuar 1443 çështje, ndërsa në datën 15.12.2021 ngarkesa e saj ka shkuar në 3707 çështje. Çështjet gjyqësore janë vënë në lëvizje sipas radhës kohore dhe po shqyrtohen ato të regjistruara në periudhën shtator 2016–shkurt 2017, ndërkohë që çështja e kërkueses është regjistruar në shtator të 2017-ës.

55. Ngarkesa e lartë e punës pranohet edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), i cili është organi kushtetues që sipas nenit 147, pika 1, të Kushtetutës ka përgjegjësinë për të siguruar jo vetëm pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e pushtetit gjyqësor, por edhe mbarëvajtjen e tij. Kështu, KLGJ-ja ka raportuar se në vitin 2020 Gjykata Administrative e Apelit paraqet një nivel të ulët të eficiencës në drejtim të rritjes së çështjeve të prapambetura dhe zgjatjes së afateve kohore, me tregues të tillë si: i. rendimenti mesatar i likuidimit të çështjeve për gjyqtar është ulur me 61% në vitin 2020 krahasuar me një vit më parë; ii. norma e likuidimit të çështjeve është ulur nga 86% në vitin 2019, në 37% në vitin 2020; iii. koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje është rritur nga 1171 ditë në 4020 ditë (*shih "Raporti mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020", i miratuar me vendimin nr. 176, datë 29.4.2021, faqet 11 dhe 87*). Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se pavarësisht masave të planifikuara nga KLGJ-ja, të shprehura edhe në planin e veprimit janar 2019–dhjetor 2020 për reduktimin e çështjeve të mbartura në gjykatat e të gjitha niveleve përmes hartimit të planeve të veprimit (*shih objektivin nr. 1.5 dhe aktivitetet e planifikuara në synimin nr. 1, "Përshpejtimi i reformës së pushtetit gjyqësor dhe akordimit të burimeve", në Planin e Veprimit të KLGJ-së për sistemin gjyqësor 2019–2020*), ende mungojnë treguesit për përmirësimin e gjendjes në Gjykatën Administrative të Apelit, për rrjedhojë këto masa duket se nuk kanë dhënë efektet e duhura në rastin e çështjes së kërkueses.

56. Duke i analizuar treguesit e mësipërm, Gjykata çmon se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkueses është pasojë e ngarkesës së lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe ngarkesës së lartë të punës së gjyqtares relatore, e shkaktuar nga ulja e numrit të gjyqtarëve për shkak të zbatimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, pjesë e reformës në drejtësi. Gjykata, në bazë të standardeve të përmendura në paragrafin 53 të këtij vendimi, duke mbajtur në konsideratë faktin se kjo lloj ngarkese pune është duke zgjatur disa vite, se numri i gjyqtarëve vijon në rënie dhe se metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja nuk po i japin zgjidhje ngarkesës së punës, vlerëson se sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti e atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke i shkaktuar kërkueses vonesë të paarsyeshme në gjykimin e çështjes së saj.

57. Gjykata thekson se gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, që efektet e zbatimit të reformës në drejtësi janë të përkohshme dhe që gjykatat të plotësohen me personel dhe të organizohen në kohën e duhur dhe sipas standardeve kushtetuese, nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve. Për më tepër, mbingarkesa në gjykata është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga kërkuesja, por vetëm nga përgjegjësit e administrimit të sistemit të drejtësisë, detyra e të cilëve është të krijojnë një sistem gjyqësor efikas dhe të pajisur me personel, në mënyrë që t'i përgjigjet më së miri kërkesave të shtetit të së drejtës, ku përfshihet edhe përfundimi i proceseve gjyqësore në përputhje me standardet që imponon e drejta për proces të rregullt, ndërkohë që ky detyrim kushtetues prej tyre nuk rezulton të jetë respektuar.

58. Në përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret është cenuar e drejta e kërkueses për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se vlerësimi i kryer nga Gjykata e Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, për rrjedhojë vendimi i saj për rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave duhet të shfuqizohet dhe gjykimi i ankimit të kërkueses nga Gjykata Administrative e Apelit duhet të përshpejtohet. Për këtë qëllim, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon të caktojë afatin 6-mujor brenda të cilit duhet të veprojë Gjykata Administrative e Apelit. Në vlerësimin e Gjykatës ky afat konsiderohet i arsyeshëm në raport me të drejtën kushtetuese të kërkueses, por, gjithashtu, u përgjigjet kushteve dhe mundësive aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, e cila është duke shqyrtuar çështjet e regjistruara në periudhën shtator 2016–shkurt 2017.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.
3. Shfuqizimin e vendimit nr. 2/5/2, datë 17.6.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.2.2022.
Shpallur më 15.3.2022.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë pro: Fiona Papajorgji, Përparim Kalo, Altin Binaj, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari
Anëtarë kundër: Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur në këtë çështje në lidhje me pretendimin e kërkueses për cenimin e standardit të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Shumica ka arsyetuar se në rastin e kërkueses ka pasur shkelje të procesit të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes së saj brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit. Sipas saj, në çështjen në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të procedurave gjyqësore, e cila, *së pari*, nuk i atribuohet kërkueses, që ka vepruar në përputhje me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë pengesë për vonesa, *së dyti,* çështja paraqitet komplekse, por jo në masën që të justifikojë vonesën e gjykimit në shkallë të dytë më shumë se 4 vjet, dhe, *së treti,* sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti e atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke i shkaktuar kërkueses vonesë të paarsyeshme në gjykimin e çështjes së saj. Në përfundim, shumica ka vlerësuar të bazuar dhe ka pranuar pretendimet e kërkueses për sa i

përket sjelljes së autoriteteve, duke arsyetuar se veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë shkaktuar tejzgjatjen e afatit të arsyeshëm në rastin e saj.

3. Konkretisht, shumica shprehet: "Duke i analizuar treguesit e mësipërm, Gjykata çmon se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkueses është pasojë e ngarkesës së lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe e ngarkesës së lartë të punës së gjyqtares relatore, e shkaktuar nga ulja e numrit të gjyqtarëve për shkak të zbatimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, pjesë e reformës në drejtësi. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë faktin se kjo lloj ngarkese pune po zgjat me vite, se numri i gjyqtarëve vijon në rënie dhe se metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja nuk po i japin zgjidhje ngarkesës së punës, vlerëson se sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti e atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke i shkaktuar kërkueses vonesë të paarsyeshme në gjykimin e çështjes së saj. Gjykata thekson se gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, që efektet e zbatimit të reformës në drejtësi janë të përkohshme dhe që gjykatat të plotësohen me personel dhe të organizohen në kohën e duhur e sipas standardeve kushtetuese, nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve. Për më tepër, mbingarkesa në gjykata është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga kërkuesja, por vetëm nga përgjegjësit e administrimit të sistemit të drejtësisë, detyra e të cilëve është që të krijojnë një sistem gjyqësor efikas dhe të pajisur me personel, në mënyrë që t'u përgjigjet më së miri kërkesave të shtetit të së drejtës, ku përfshihet edhe përfundimi i proceseve gjyqësore në përputhje me standardet që imponon e drejta për proces të rregullt, ndërkohë që ky detyrim kushtetues prej tyre nuk rezulton të jetë respektuar *(shih paragrafët 56 dhe 57 të vendimit)*.

4. Lidhur me këtë çështje, në parim kam qëndrim ndryshe se cilat janë kriteret e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe si janë analizuar ato, e për rrjedhojë se si janë zbatuar në rastin konkret, të cilat do t'i parashtroj në vijim.

5. Në vlerësimin tim, shumica nuk ka respektuar standardet e Gjykatës Kushtetuese për sa u përket kritereve të kohëzgjatjes së arsyeshme të proceseve gjyqësore. Kjo Gjykatë, në jurisprudencën e saj, rishtazi, pas hyrjes në fuqi të dispozitave për kohëzgjatjen e arsyeshme të proceseve gjyqësore, parashikuar në nenet 399 e vijim të KPC-së, ka mbajtur qëndrimin se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm gjykimi *(shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Konkretisht, në këto vendime, krahas kriterit vlerësues të sjelljes së kërkuesit, Gjykata afirmoi si kriter veçanërisht të rëndësishëm "interesin e lartë të kërkuesit dhe rrezikun që passjell tejzgjatja e procedurave për të". Në këto çështje, sjellja e kërkuesit u analizua bashkë me interesin e kërkuesit dhe çfarë ai rrezikonte nga tejzgjatja *(shih paragrafin 60, "Sjellja/interesi për kërkuesen dhe rrezikun që passjell tejzgjatja e procedurave për të" të vendimit nr. 33, datë 1.11.2021, si dhe paragrafin 49, të vendimit nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Një nga çështjet e trajtuara nga Gjykata në këto vendimmarrje kishte si kërkues një pensionist, ndërsa çështja kishte të bënte me pension pleqërie *(shih paragrafin 51, të vendimit nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata e vlerësoi çështjen me kujdes të posaçëm dhe rigorozitet, duke pranuar pretendimet e parashtruara nga kërkuesi, si dhe detyroi Gjykatën e Lartë që brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të saj të gjykonte çështjen e tij.

6. Vendimet e cituara përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe vendosin standarde edhe për veprimtarinë e gjyqësorit të zakonshëm. Kjo "doktrinë kushtetuese zyrtare" në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të proceseve u pa nën dritën e standardeve të GJEDNJ-së në çështjen *Bara dhe Kola k. Shqipërisë,* vendim i datës 12.10.2021 *(shih vendimin nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*, ndaj dhe kriteret u riinterpretuan në mënyrë të tillë, nga kjo Gjykatë, që edhe pse situata e reformës në drejtësi ka sjellë efekte të ngarkesës dhe akumulimit të çështjeve tej parashikimit, të ruhet sistemi i vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, përmes forcimit të garancive mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, si dhe të garancive të të drejtave dhe lirive të individit në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara përgjithësisht.

7. Ky kriter, pra "interesi i kërkuesit dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të", përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, çka është pranuar edhe nga kjo Gjykatë që përpara ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, kur ajo kontrollonte

standardet e kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe vetëm konstatonte shkeljen përmes vendimeve deklarative në këtë aspekt të procesit *(shih vendimet nr. 14, datë 10.3.2016, paragrafët 10 dhe 14; nr. 76, datë 4.12.2017, paragrafi 19, të Gjykatës Kushtetuese)*. Po ashtu, edhe në vendime të fazës tranzitore, ku kjo Gjykatë vazhdonte vetëm të konstatonte shkeljen, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ajo ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuesit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimin nr. 16, datë 16.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 24*).

8. Për rrjedhojë, bazuar në sa më lart, vlerësoj se kriteri përcaktues dhe i domosdoshëm që duhet të merret në konsideratë nga Gjykata në çështjet në diskutim, është "interesi i lartë i kërkuesit, si dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të", pasi *vetëm ky kriter mund të bëjë dallimin*, në situatën konkrete të ngarkesës, mes nevojës për të zgjidhur të gjitha çështjet sipas afateve të arsyeshme, në zbatim të nenit 399 e vijues të KPC-së, dhe mundësisë e kapaciteteve aktuale të gjyqësorit për të respektuar këtë standard.

9. Duke analizuar rastin konkret, edhe pse nga shumica pranohet se: "Volumi i punës së gjyqtares relatore, që i është caktuar për shqyrtim çështja e kërkueses, është rritur, pasi në datën 19.9.2017, asaj i ishin caktuar 1443 çështje, ndërsa në datën 15.12.2021, ngarkesa e saj ka shkuar në 3707 çështje" (*shih paragrafin 54 të vendimit*), përsëri ajo ka vlerësuar se në rastin konkret është cenuar e drejta e kërkueses për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit brenda afatit të arsyeshëm, dhe se kjo gjykatë brenda 6 muajve duhet të shqyrtojë çështjen, pasi ky afat u përgjigjet kushteve dhe mundësive aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, (relatores), e cila është duke shqyrtuar çështjet e regjistruara në periudhën shtator 2016–shkurt 2017 (*shih paragrafin 58 të vendimit*). Nga ana tjetër, nga rrethanat rezulton se në datën 20.7.2018, kërkuesja i është drejtuar me shkrim relatores së çështjes dhe kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar përshpejtimin e gjykimit të ankimit dhe nuk ka marrë përgjigje *(shih paragrafët 6 dhe 7 të vendimit)*.

10. Për sa më lart, duke mos iu përmbajtur kritereve kushtetuese të vëna prej saj me jurisprudencën ndër vite (2006–2016) dhe që prezumohet kanë gjetur pasqyrim edhe në kuadrin ligjor e nënligjor, të miratuar më pas, shumica ka ndërhyrë në kompetencat e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në rastin konkret në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve nga relatorja, i cili merr parasysh edhe gjendjen aktuale të ngarkesës së gjyqësorit, duke ndryshuar kështu kriteret për prioritizimin e çështjeve për shqyrtim para këtyre gjykatave *(shih për më tepër nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012; nenin 460, pika 3, të KPC-së; si dhe vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit" të Këshillit të Lartë Gjyqësor)*.

11. Ndërkohë, te kriteri "sjellja e kërkuesit", sikundër theksova edhe më lart, shumica as nuk e ka vendosur si kriter më vete interesin e kërkueses dhe pasojat e tejzgjatjes, për rrjedhojë në mendimin tim, duke mos i vënë theksin as në strukturën formale të vendimit (*shih paragrafin 40 të vendimit "Sjellja e kërkueses"*), as nuk e ka analizuar atë me vëmendje të posaçme, duke mos respektuar kështu standardet e mëparshme të vendosura nga Gjykata në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit, çka krijon paqartësi për zbatimin e kritereve që duhet të aplikohen për çështje të kësaj natyre dhe në të ardhmen.

12. Duke analizuar rastin konkret nën dritën e kriterit "*sjellja dhe interesi i kërkueses/ çfarë ajo rrezikon dhe pasojat që mund t'i vijnë nga tejzgjatja",* në thelb kjo çështje nuk rezulton të jetë e tillë që, për shkak të natyrës së saj, të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit, pasi ajo çfarë kërkuesja rrezikon në këtë konflikt gjyqësor nuk përfshihet në të drejta dhe interesa të natyrës veçanërisht serioze.

13. Në përfundim, në arsyetimin e saj shumica shprehet se Gjykata thekson, gjithashtu, domosdoshmërinë e përshpejtimit të procedurës së gjykimit të çështjes së themelit të kërkueses dhe, për këtë qëllim, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ajo do të caktojë në pjesën urdhëruese të këtij vendimi edhe afatin brenda të cilit duhet të veprojë Gjykata Administrative e Apelit. Në vlerësimin e Gjykatës ky afat konsiderohet i arsyeshëm dhe u përgjigjet kushteve dhe mundësive të Gjykatës Administrative të Apelit për të vepruar në çështjen e kërkueses, e cila është duke shqyrtuar çështjet e regjistruara në periudhën shtator 2016–shkurt 2017. Sipas dispozitivit, urdhërohet gjykata ta shqyrtojë çështjen brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

14. Për sa më lart, duke pranuar se ka shkelje të kohëzgjatjes së arsyeshme dhe duke vendosur detyrim për Gjykatën Administrative të Apelit që brenda 6 muajve të shqyrtojë themelin e çështjes, shumica nuk ka reflektuar qasjen e duhur as mbi efektivitetin e vendimeve të saj, të cilat rrezikojnë të mbeten të pazbatuara, dhe mbi pamundësinë apo mundësinë e kësaj gjykate për të shqyrtuar këtë çështje. Në këtë drejtim ajo nuk ka qartësuar se mbi çfarë kriteresh e konsideron afatin 6-mujor të arsyeshëm dhe që u përgjigjet kushteve e mundësive të Gjykatës Administrative të Apelit (relatores) për të vepruar në çështjen e kërkueses. Argumenti "sipas periudhës kohore", i ka ardhur koha, nuk është i mjaftueshëm për të dalë në konkluzionin se për këtë arsye Gjykata e Apelit Administrativ ka mundësi ta shqyrtojë brenda 6 muajve.

15. Nga ana tjetër, vendimi nr. 78/2019, i KLGJ-së, *"Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit"* për sa i përket kategorisë ka parashikuar se kërkojnë, gjithashtu, përparësi në përshpejtim çështjet që duhen shqyrtuar për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese *(shih pikën 3.2, të vendimit nr. 78/2019, të KLGJ-së)*, një arsye më tepër për të pasur kujdes në vënien e afateve, që mund të krijojnë përplasje me kalendarin e çështjeve, ku mund të ketë çështje më prioritare.

16. Në vështrim të sa më sipër, mendoj se qëndrimi i shumicës është një vlerësim i nxituar dhe i shkëputur nga realiteti kompleks i organizimit dhe funksionit të gjyqësorit të zakonshëm aktualisht, edhe pse shkresa e dërguar nga Gjykata e Apelit Administrativ e pasqyron më së miri këtë realitet me mbingarkesë çështjesh gjyqësore.

17. Ky qëndrim i pakicës nuk nënkupton në asnjë rast që sistemi gjyqësor nuk duhet të jetë në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, megjithatë kjo Gjykatë krahas sigurimit të njëtrajtshmërisë të jurisprudencës kushtetuese, për sa i takon vlerësimit të faktorëve që duhet të garantojnë standardet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet edhe të konstitucionalizojë gjyqësorin e zakonshëm përmes vendimeve të saj. Megjithatë, Gjykata, duke mos zbatuar kritere të sakta dhe të qarta, po i orienton këto lloj procesesh gjyqësore në subjektivizëm, duke sjellë pasoja edhe për gjyqësorin e zakonshëm, i cili përveç kritereve të sipërcituara nga jurisprudenca, por edhe aktet ligjore dhe nënligjore do të duhet të orientohet drejt zhvillimit të proceseve gjyqësore edhe sipas kritereve (në fakt, mungesës së kritereve të qarta) të vëna prej Gjykatës Kushtetuese në lidhje me "interesin e kërkuesit dhe çfarë ai rrezikon".

18. Si përfundim, vlerësoj se kërkesa e kërkueses duhej të rrëzohej, duke marrë në konsideratë kriterin e interesit/rrezikut që passjell për kërkuesen tejzgjatja e procedurave gjyqësore, në kontekstin konkret të ngarkesës dhe akumulimit të çështjeve, edhe nga efektet e reformës në drejtësi.

Tiranë, më 17.2.2022.
Anëtare: Elsa Toska